



Kriteret Industriale të KGTTQ-së

VERSIONI 3, 21 DHJETOR 2016

ME

Indikatorët e sugjeruar të performancës për hotele dhe akomodime

Hyrje

Kriteret e Këshillit Global për Turizëm të Qëndrueshëm u krijuan për të siguruar një kuptim të përbashkët të “turizmit të qëndrueshëm” në gjithë botën dhe janë niveli minimal që secili biznes i turizmit duhet të synojë të arrijë. Janë të organizuara rreth katër temave kryesore: planifikimi efektiv i qëndrueshëm, arritja maksimale e përfitimeve sociale dhe ekonomike për komunitetin lokal, rritja e trashëgimisë kulturore dhe ulja e ndikimeve negative mbi mjedisin. Ata janë të përfshirë në gjithë industrinë e turizmit.

Kriteret janë hartuar dhe rishikuarr duke synuar aderimin e Kodit për Vendosijen e Standardit të Aleancës ISEAL, një autoritet i njohur për të dhënë udhëzime për normat ndërkombëtare të zhvillimit të standardeve të qëndrueshme në të gjitha sektorët. Kriteret rishikohen çdo 3 deri 5 vite. Planet për revizione si dhe regjistrime për informacione publike për revizionet në të ardhmen mund të gjenden në www.gstcouncil.org. Kjo web faqe gjithashtu ofron informacione për procesin dhe historikun e zhvillimit të Kriteve.

Kriteret përdoren për sa më poshtë:

- Shërbejnë si bazë për çertifikim të qëndrueshmërisë
- Shërbejnë si udhëzues baze themelore për bizneset e gjitha madhësive që të bëhen më të qëndrueshme, dhe ndihmojnë biznese të zgjedhin programe të turizmit të qëndrueshëm që i plotësojnë këto kritere globale
- Sigurojnë qasje më të madhe në tregjet në rritje për produkte të qëndrueshme, duke shërbyer si udhëzues, si për udhëtarët ashtu edhe për agjencitë e udhëtimit, gjatë zgjedhjes së furnizuesve dhe programeve të turizmit të qëndrueshëm
- Ndihmojnë konsumatorët të identifikojnë programe dhe biznese të turizmit të qëndrueshëm

- Shërbejnë si përcaktues i përbashkët për media të informacionit për të njohur furnizuesit e turizmit të qëndrueshëm
- Ndihmojnë certifikimin dhe programet tjera vullnetare për të siguruar që standardet e tyre plotësojnë kriteret bazat të njohura gjërësisht.
- Ofrojnë programeve qeveritare, joqeveritare dhe të sektorit privat një pikë nisjeje për zhvillimin e kriterëve të turizmit të qëndrueshëm
- Shërbejnë si udhëzues themelore për institucionet e arsimit dhe trajnimit, si shkollat e hotelerisë dhe universitetet
- Tregojnë udhëheqje që inspirojnë tjerët të veprojnë

Kriteret përcaktojnë se çfarë duhet të bëhet, jo në çfarë mënyre ose nëse qëllimi është arritur. Ky rol plotësohet nga indikatorët e performancës, materialet përkatëse edukative dhe qasje në mjetet për zbatim, që janë të gjitha një plotësim i domosdoshëm i KGTQ Kriterëve.

Përdorimi i kriterëve

Rekomandohet që gjithë kriteret të përdoren në nivelin më të lartë praktik, përveç në disa raste specifike në të cilat kriteri nuk mund të zbatohet dhe ka arsyetim të fuqishëm për atë. Mund të paraqiten situata në të cilat kriteri nuk mund të zbatohet për ndonjë produkt të caktuar, duke marrë parasysh kushtet lokale të rregullimit, mjedisit, sociale, ekonomike ose kulturore. Në rast të bizneseve mikro dhe në pronësi të komunitetit që kanë mbeturina të vogla sociale, ekonomike dhe mjedisore, kuptohet që resurset e kufizuara mund të shkaktojnë që mos të mund të zbatohen gjitha kriteret. Më tepër udhëzime mbi këto kriterë mund të gjenden nga indikatorët dhe fjalorthi që janë publikuar bashkë me këtë dokument.

Indikatorët e performancës

Indikatorët e performancës të prezantuar në këtë dokument janë dizajnuar për të ofruar udhëzime për matjen e përputhjes me kriteret e KGTQ-së për hotelet.

Kjo listë e indikatorëve do të përditësohet në baza periodike, me zhvillimin e informacioneve të reja. Nëse dëshironi të propozoni indikatorë të rinj ose të sugjeroni përmirësim, ju lutemi që të dërgoni në accreditation@gstccouncil.org.

Indikatorë dhe kritere të kombinuara

Ky dokument përmban kriteret dhe indikatorët e performancës.

KRITERET INDUSTRIALE TË KGTQ-SË

INDIKATORËT PËR HOTELET

SEKSIONI A: Dëshmon menaxhim efektiv të qëndrueshëm

A1 Sistemi i menaxhimit të qëndrueshmërisë

Organizata ka zbatuar një sistem afatgjatë të menaxhimit të qëndrueshmërisë që përshtatet me madhësi dhe shtrirje, trajton çështjet mjedisore, sociale, kulturore, ekonomike, cilësore, të drejtat e njeriut, shëndetësore, menaxhimin e riskut dhe rreziqeve dhe synon përmirësimin e vazhdueshëm.

- Sistemi për Menaxhim të Qëndrueshmërisë është dokumentuar në mënyrë të qartë.
- Sistemi për MQ mbulon çështjet mjedisore, sociale, kulturore, ekonomike, cilësore, të drejtat e njeriut, shëndetit dhe sigurisë.
- Sistemi i MQ përfshin gjithashtu edhe menaxhimin e riskut dhe krizave.
- Shqyrtimi i dokumenteve tregon zbatimin e sistemit për MQ.
- Sistemi i MQ përfshin një sistem të monitorimit të përmirësimit të vazhdueshëm për menaxhimin të qëndrueshmërisë.

A2 Përputhja ligjore

Organizata është në përputhje me gjitha dispozitat ligjore lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare dhe rregulloret, përfshirë, mes tjerash, edhe aspektet e shëndetësisë, sigurisë, punës dhe të mjedisit.

- Mbahet një listë e të gjitha kriterëve të vlefshme ligjore.
- Me certifikata ose dokumentet tjetra dëshmohej përputhje me të gjitha dispozitat e vlefshme ligjore.
- Kriteret ligjore në të gjitha vendet e punës janë të kuptuara dhe plotësuar.

A3 Raportimi dhe komunikimi

Organizata komunikon qëndrueshmërinë, politikat, veprimet dhe performancën aksionarëve, përfshirë edhe konsumatorët, dhe synon të angazhojë mbështetjen e tyre.

- Publikohen raporte të rregullta për menaxhimin e qëndrueshmërisë.
- Politikat dhe veprimet e qëndrueshmërisë raportohen me material të jashtëm dhe të brendshëm të komunikimit.
- Komunikimet përmbajnë mesazhe me të cilat kërkohet mbështetja e konsumatorëve dhe aksionarëve.

A4 Angazhimi i personelit

Personeli është i angazhuar në zhvillimin dhe zbatimin e sistemit për drejtimin e qëndrueshmërisë dhe marrin udhëzime dhe trajnime periodike në lidhje me rolet dhe përgjegjësitë e tyre gjatë zbatimit.

- Ka dëshmi mbi përfshirjen e personelit me sistemin e MQ.
- Janë në dispozicion regjistra të kurseve dhe trajnimeve në vendin e punës me nivelin e pjesëmarrjes.
- Trajnimi i personelit dhe materiale për training mund të gjenden në format të kuptueshëm (përfshirë edhe përdorimi i gjuhëve të komuniteteve pakice, nëse ka nevojë).
- Personeli ka certifikate dhe kualifikime në disiplinat/aftësitë relevante.

A5 Përvoja e konsumatorit

Kënaqësia e konsumatorit, përfshirë edhe aspekte të qëndrueshmërisë, monitorohet dhe ndërmerren hapa të korigjimit.

- Ka një sistem të reagimit të konsumatorëve, bashkë me analizë të rezultateve.
- Reagimet dhe përgjigjet negative në lidhje me këtë janë të regjistruar.
- Ka dëshmi për hapa korigjuese të ndërmarra .
- Sigurohet reagimi nga konsumatorët për bizneset e turizmit dhe vendet e kontraktuara/vizituara.

A6 Promovim i saktë

Materialet e promovimit dhe komunikimet për marketing janë të saktë dhe transparent në kuptim të organizatës dhe produktet dhe shërbimet, përfshirë edhe pohimet për qëndrueshmëri. Nuk premtohet më tepër sesa ofrohet.

- a. Pamjet e përdorura në promovim janë përvoja të vërteta të ofruar dhe nga objekte të sakta.
- b. Pohimet për qëndrueshmëri janë të bazuar në përvoja të arritjeve në të kaluarën.

A7 Ndërtesat dhe infrastruktura

Planifikimi, vijimi, dizajni, ndërtimi, rinovimi, zhvillimi dhe demolimi i ndërtesave dhe infrastrukturës...

Indikatorët për kriteret e A7 kanë të bëjnë me ndërtesa dhe infrastruktura të akomodimit që certifikohet

A7.1 Përputhja

...me kriteret për zonë dhe ligjet lidhur me rajonet e mbrojtura dhe sensitive dhe trashëgimisë.

- a. Dëshkohet ndërgjegjësimit dhe përputhje me ligjet lidhur me përdorimin e tokës dhe aktivitete në rajonin lokal.
- b. Të gjitha licencat dhe lejet janë të përditësuar.
- c. Dëshkohet ndërgjegjësimit dhe përputhje me të gjitha planet e drejtimit jo të detyrueshëm të rajonit dhe udhëzimet (p.sh. për zonat e veçanta, dizajnë, etj.).

A 7.2 Ndikimi dhe integriteti

...merret parasysh kapaciteti dhe integriteti i rrethit natyror dhe kulturor.

- a. Zgjedhja e vendit, dizajni dhe qasja kanë marrë parasysh komoditetin vizual, peizazhin, trashëgiminë kulturore dhe natyrore.
- b. Zgjedhja e vendit, dizajni dhe qasja kanë marrë parasysh mbrojtjen e rajoneve të ndjeshme biologjike dhe kapacitetin asimilues të sistemeve ekologjike.
- c. Integriteti i vendeve arkeologjike, trashëgimisë kulturore dhe vendeve të shenjta është ruajtur.
- d. Integriteti dhe lidhja e vendeve natyrore dhe zonave të mbrojtura është ruajtur.
- e. Speciet e kërcënuara ose të mbrojtura nuk janë zhvendosur dhe ndikimi mbi vendbanimet e kafshëve të egra është minimizuar dhe zbutur.
- f. Rrjedhat e ujit/ujë mbledhjet/moçalet nuk janë ndryshuar dhe derdhjet janë ulur sipas mundësisë dhe çdo mbeturinë është vendosur në kontroll ose drejtuar dhe filtruar.
- g. Faktorët e rrezikut (përfshirë edhe ndryshimet klimatike, fenomenet natyrore dhe siguria e vizitorëve) janë vlerësuar dhe adresuar.
- h. Vlerësimi i ndikimit (përfshirë edhe ndikimet kumulative) janë zhvilluar dhe dokumentuar në mënyrën përkatëse.

A7.3 Praktikave të qëndrueshme dhe materialet

...përdorimi i praktikave të qëndrueshme lokale dhe materialet.

- Janë përdorur materiale lokale, praktika dhe vepra artizanale për ndërtesat dhe dizajn në vende të përshtatshme.
- Janë përdorur bimë autoktone dhe endemike nga burime të qëndrueshme për peisazhin dhe dekorimin, duke shmangur speciet ekzotike dhe invazive.
- Bimët janë zgjedhur për aftësinë e tyre për të mbijetuar kushtet e vështira, p.sh bimë që tolerojnë thatësira.
- Dizajne të qëndrueshëm, materiale dhe praktika të ndërtimit janë përdorur në ndërtesa, me certifikimin e mundshëm.
- Mbeturinat nga ndërtimet janë ndarë dhe larguar duke respektuar mjedisin.

A7.4 Qasje për të gjithë

...sigurimi i qasjes dhe informacioneve për personat me aftësi të kufizuara, në vendet e duhura.

- Vendet, ndërtesat dhe aktivitetet mund të qasen nga personat me aftësi të kufizuara fizike dhe nevoja të tjera, në përputhje me natyrën e punimeve.
- Janë dhënë informacione të qarta dhe të sakta për nivelin e qasjes.
- Qasja është certifikuar ose kontrolluar nga ekspertët/autoritetet përkatëse.

A8 Të drejtat mbi tokën, ujin dhe pronësinë

Marrja nga organizata e të drejtave të tokës dhe ujit bëhet në mënyrë ligjore, në përputhje me të drejtat komunale dhe autoktone, përfshirë edhe pëlqimin e tyre të lirë, paraprake dhe të informuar, dhe nuk përfshin zhvendosje jo vullnetare.

- Pronësia dhe qiraja mbi tokën është dokumentuar.
- Të drejtat e përdorimit dhe qasjes në resurse kryesore, përfshirë edhe tokën dhe ujin janë të dokumentuar në mënyrën e duhur.
- Ka dëshmi të dokumentuar të komunikimit, konsultimit dhe angazhimit të komuniteteve lokale dhe autoktone.
- Dëshmia për pëlqimin paraprak të lirë dhe të informuar të komuniteteve lokale është dëshmuar, sipas nevojave (duke dëshmuar që nuk ka zhvendosje të pavullnetshme dhe marrje të tokës).

A9 Informimi dhe interpretimi

Organizata siguron informacione dhe interpretim për rrethinën natyrore, kulturën lokale dhe trashëgiminë kulturore, si dhe sqarim për sjelljen e përshtatshme gjatë vizitës së rajoneve natyrore, kulturave dhe vendeve të trashëgimisë kulturore.

- Materiale të informimit/interpretimit për trashëgimitë natyrore dhe kulturore të rajonit lokal janë në dispozicion dhe jepen konsumatorëve.
- Personeli është informuar dhe trajnuar për trashëgiminë natyrore dhe kulturore të rajonit lokal.
- Sigurohen informacione për konsumatorët në lidhje me sjelljen përkatëse në rajonin lokal.

A10 Angazhimi në destinacion

Organizata është përfshirë në planifikimin e turizmit të qëndrueshëm dhe menaxhimin në destinacion, në vendet ku ka mundësi.

- organizata është anëtare e Organizatës për Menaxhim të Destinacionit ose ndonjë autoriteti të ngjashëm, në vendet ku mund të ketë organizatë të atillë.
- Organizata merr pjesë në partneritetet mes komuniteteve lokale, OJQ-ve dhe autoriteteve lokale.
- Organizata merr pjesë në takime të planifikimit dhe menaxhimit dhe aktivitete me temë turizmin e qëndrueshëm në vendin përkatës.

SEKSIONI B: Maksimizimi i përfitimeve sociale dhe ekonomike për komunitetin lokal dhe minimizimi i ndikimeve negative

B1 Mbështetja e komunitetit

Organizata mbështet në mënyrë aktive iniciativa për infrastrukturë lokale dhe zhvillimin social të komunitetit. Shembuj të iniciativave mund të jenë arsimi, trajnimi, shëndeti dhe projekte sanitare dhe tjera që trajtojnë ndikimin e ndryshimit klimatik.

- Organizata mbështet iniciativa me komunitetet lokale në fushat në të cilat është më tepër aktive.
- Niveli dhe natyra e kontributit të bërë për skemat e komunitetit lokal është regjistruar.
- Gjatë përzgjedhjes së furnizuesve të shërbimeve dhe produkteve/përvojave për të marrë pjesë në programet, organizata favorizon ata që angazhohen dhe mbështetin komunitetet lokale.

B2 Punësimi lokal

Banorëve lokal ju janë dhënë mundësi të barabartë për punësim dhe avancim, përfshirë në pozitat drejtuese.

- Organizata synon që të sigurojë mundësi punësimi për banorët lokal në punët dhe aktivitetet.
- Organizata monitoron nivelet dhe proporcionin e punësimit që siguron për banorët lokal.
- Trajnime ofrohen për banorët lokal për të rritur mundësitë e tyre të punësimit.

B3 Prokurimet lokale

Gjatë prokurimit dhe ofrimit të mallrave dhe shërbimeve, organizata i jep prioritet furnizuesve lokal dhe tregtarëve, kur ato janë të gatshëm dhe të jenë me cilësinë e duhur.

- Organizata në mënyrë të rregullt bën auditimin e furnizimit të mallrave dhe shërbimeve.
- Proporcioni i mallrave dhe shërbimeve të prokuruar në mënyrë lokale dhe nga bizneset lokale matet dhe drejtohet.
- Proporcioni i prokurimeve jo-lokale dhe bizneseve që janë të përshtatshme maten dhe menaxhohen.

B4 Sipërmarrësit lokal

Organizata mbështet sipërmarrësit lokal në zhvillimin dhe shitjen e produkteve të qëndrueshme dhe shërbimeve të janë të bazuar në natyrën, historinë dhe kulturën e rajonit.

- Bizneset lokale kanë qasje prioritare për vende dhe konsumatorë për aktivitete komerciale.
- Aty ku përshtatet, organizata siguron këshillë dhe mbështetje për furnizuesit lokal të cilët i angazhon, në bazë të cilësisë dhe qëndrueshmërisë së shërbimeve.
- Mundësitë për partneritete dhe lidhje të kompanive me ndërmarrësit lokal merren parasysh dhe inkurajohen.

B5 Shfrytëzimi dhe keqtrajtimi

Organizata ka zbatuar politika kundër shfrytëzimit komercial, seksual ose formave tjera, posaçërisht të fëmijëve, adoleshentëve, grave, minoriteteve dhe grupeve tjera të cenuar.

- Organizata ka të dokumentuar politika kundër shfrytëzimit dhe keqtrajtimit të grupeve të cenuar.
- Merren masa për komunikim dhe zbatim të politikave.
- Organizata angazhohet me komunitetin lokal për të punuar kundër shfrytëzimit dhe keqtrajtimit.
- Regjistra të moshës së të punësuarve mbahen dhe dëshmojnë për mungesën e gjitha formave të punës së fëmijëve (siç përcaktuar nga ILO).

B6 Shanse të barabarta

Organizata ofron mundësi të punësimit, përfshirë pozitat e drejtimi, pa diskriminim në bazë të gjinisë, racës, fesë, aftësisë së kufizuar ose formave tjera.

- Organizata ka identifikuar grupe në rrezik nga diskriminimi, përfshirë gratë dhe pakicat lokale.
- Proporcioni i të punësuarve të ardhur nga këto grupe është monitoruar dhe përcaktohet me demografi lokale.
- Promovimi i brendshëm përfshin anëtarë të këtij grupi.

B7 Punë e ndershme

Të drejtat e punës respektohen, garantohej një mjedis pune i sigurt dhe të punësuarit paguhen së paku një rrogë për të jetuar (minimumi jetik). Të punësuarve ju ofrohen trajnime të rregullta, avancim.

- a. Organizata dëshmon vetëdije dhe përputhje me standardet dhe rregulloret ndërkombëtare të punës.
- b. Nivelet e rrogave janë të monitoruar dhe shqyrtuar në baza të rregullta në krahasim me normat kombëtare për punësim.
- c. Mbahen regjistra të trajnimit për gjithë stafin, duke treguar nivelet dhe frekuentueshmerinë të trajnimeve.
- d. Kontratat e të punësuarve tregojnë mbështetje për kujdesin shëndetësor dhe sigurimet shoqërore.
- e. Paisjet për ujin, sanitetin dhe higjenën sigurohen për gjithë punonjësit në vendin e punës.
- f. Monitorohet kënaqësia e të punësuarve.
- g. Një mekanizëm për ankesë për të punësuarit gjendet në dispozicion.

B8 Shërbimet e komunitetit

Aktivitetet e organizatës nuk rrezikojnë sigurimin e shërbimeve themelore, siç janë ushqim, ujë, energji elektrike, kujdes shëndetësor ose sanitari për komunitetet fqinje.

- a. Organizata monitoron ndikimin mbi gatishmërinë e shërbimeve lokale.
 - b. Për komunitetin lokal ka mekanizëm për komunikim, informacione kthyesë dhe ankesë.
 - c. Çdo keqësim të shërbimeve themelore për komunitetet lokale, të identifikuar si rezultat i aktiviteteve të organizatës trajtohet.
-

B9 Vendbanimet lokale

Aktivitetet e organizatës nuk ndikon negativisht mbi qasjet lokale të vendbanimeve, përfshirë përdorimin e resurseve në tokë dhe ujë, transport dhe akomodim.

- a. Qasja lokale në vendbanime merret parasysh gjatë vendimeve për zhvillime dhe punime.
- b. Ka një mekanizëm për komunikim për komunitetet lokale për të raportuar çdo paraqitje të qasjes së zvogëluar në vendbanimet lokale.

SEKSIONI C: Maksimizimi i përfitimeve nga trashëgimia kulturore dhe minimizimi i ndikimeve negative

C1 Bashkëveprimet kulturore

Organizata ndjek praktikën e mira ndërkombëtare dhe kombëtare dhe udhëzimet lokale për menaxhim dhe promovim të vizitave të komuniteteve autoktone dhe vendeve sensitive kulturore dhe historike për të ulur ndikimin negativ dhe maksimizimin e përfitimeve lokale dhe kënaqësinë e vizitorëve.

- a. Organizata dëshmon vetëdijen dhe përputhjen me praktikën e mira aktuale ndërkombëtare, kombëtare dhe lokale dhe udhëzime për vizita të turistëve dhe vendeve dhe komuniteteve autoktone.
- b. Organizata angazhohet me komunitetet/vendet për rishikimin e udhëzimeve dhe krijimin dhe akordimin e udhëzimeve plotësuese sipas nevojës.
- c. Udhëzimet janë efektive, përdoren dhe komunikohen.
- d. Masa të veçanta janë në vend për të shmangur bashkëveprimin e padrejtë me fëmijët.

C2 Mbrojtja e trashëgimisë kulturore

Organizata kontribuon për mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e pronave lokale, vendeve dhe traditat me rëndësi historike, arkeologjike, kulturore dhe shpirtërore dhe nuk pengohet qasja për banorët lokal.

- a. Organizata bën dhe regjistron kontributet monetare për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.
- b. Organizata siguron mbështetje të natyrës së ndryshme për trashëgiminë kulturore.
- c. Jepet kontribut për qasje lokale në vendet.

C3 Prezantimi i kulturës dhe trashëgimisë

Organizata vlerëson dhe inkorporon elemente origjinale të kulturës tradicionale dhe bashkëkohore në punën, dizajnin, dekorimin, kuzhinën, ose dyqanetet, duke respektuar të drejtat e pronave intelektuale të komuniteteve lokale.

- Vendet e vizituara dhe përvojat e ofruara sigurojnë një përvojë autentike të kulturës dhe trashëgimisë lokale.
- Trashëgimia kulturore dhe traditat aktuale mund të vërehen në kuzhinë, dyqane, evente dhe shërbime tjera që ofrohen.
- Të drejtat e pronësisë intelektuale dhe të autorsisë janë marrë parasysh dhe lejet e nevojshme janë marrë.
- Mendimet e komuniteteve lokale janë marrë parasysh gjatë prezantimit të trashëgimisë kulturore lokale.

C4 Artefakte

Artefaktet historike dhe arkeologjike nuk shiten, tregtohen ose shfaqen, përveç nëse lejohen me ligjet lokale dhe ndërkombëtare.

- Çdo përdorim i artefakteve është transparent dhe/ose i dokumentuar dhe raportuar.
- Aty ku përdoren artefaktet, janë identifikuar ligjet dhe aktet nënligjore që lejojnë këtë përdorim.
- Vizitorëve nuk ju lejohet heqja ose dëmtimi i artefakteve.

SEKSIONI D: Maksimizimi i përfitimeve nga mjedisi dhe minimizimi i ndikimeve negative
D1 Ruajtja e resurseve

D1.1 Blerja e preferuar mjedisore

Politikat e blerjes favorizojnë furnizuesit dhe produktet e qëndrueshëm mjedisor, përfshirë mallrat kapitale, ushqim, pije, materiale për ndërtim dhe lëndët e konsumueshme.

- Ka në dispozicion politika të dokumentuara të blerjes mjedisore.
- Preferencë jepet produkteve dhe furnizuesve me certifikim mjedisor – në kuptim të drurit, letrës, peshkut, ushqimeve të tjera dhe produkteve nga natyra egër.
- Aty ku nuk ka produkte dhe furnizues të certifikuar, merren parasysh origjina dhe metodat e kultivimit ose prodhimit.
- Speciet e kërcënuar nuk përdoren ose shiten.

D1.2 Blerja efikase

Organizata menaxhon në mënyrë të kujdesshme blerjen e mallrave të konsumueshme dhe të përdorimit, përfshirë ushqim, për të minimizuar mbeturinat.

- Blerja favorizon mallrat që mund të përdoren sërish, mund të kthehen ose riciklohen.
- Blerja dhe përdorimi i mallrave të konsumueshme monitorohen dhe menaxhohen.
- Paketimet e panevojshme (posaçërisht plastikë) shmangen, duke blerë me shumicë nëse mundet.

D1.3 Ruajtja e energjisë

Konsumimi i energjisë matet sipas llojit dhe ndërmerren hapa për të minimizuar konsumimin e gjerë. Organizata bënë përpjekje për të rritur përdorimin e energjisë së rinovueshme.

- a. Përdorimi total i energjisë monitorohet dhe menaxhohet.
- b. Energjia e përdorur për një turist/natë për secilin lloj të energjisë monitorohet dhe menaxhohet.
- c. Favorizohen burimet e rinovueshme dhe pjesa e energjisë së rinovueshme në furnizimin total të energjisë monitorohet dhe menaxhohet.
- d. Përdoren pajisje dhe praktika për të minimizuar përdorimin e energjisë.

D1.4 Ruajtja e ujit

Vlerësohet risku i ujit, konsumimi i ujit matet sipas llojit dhe ndërmerren hapa për të minimizuar konsumimin e gjerë. Burimet e ujit janë të qëndrueshëm dhe nuk ndikojnë negativisht mbi rrjedhat mjedisore. Në rajonet me risk të lartë të ujit, identifikohen dhe zbatohen qëllime të ruajtjes së ujit.

- d. Rreziku i ujit në vendet kryesore të vizitës është vlerësuar dhe dokumentuar.
- e. Aty ku është vlerësuar risk i lartë, janë përcaktuar qëllimet për ruajtjen e ujit.
- f. Uji i përdoruar për punët e organizatës dhe mbi ato që ka ndikim/kontroll të drejtpërdrejtë monitorohet dhe menaxhohet.
- g. Përdoren pajisje dhe praktika për të minimizuar përdorimin e ujit.
- h. Uji vjen nga burime legale dhe të qëndrueshme që nuk kanë ndikuar më parë, dhe me siguri edhe më pas, mbi rrjedhat mjedisore.
- i. Merren parasysh ndikimet kumulative të turizmit në vend për burimet e ujit.
- j. Qëllimet për uljen e konsumimit të ujit janë në dispozicion.
- k. Personeli dhe vizitorët udhëzohen për minimizimin e përdorimit të ujit.

SEKSIONI D: Maksimizimi i përfitimeve nga mjedisi dhe minimizimi i ndikimeve Negative

D2 Ulja e ndotjes

D2.1 Emisionet e gazit serrë

Emisionet e caktuara të gazit serrë nga gjitha burimet të kontrolluara nga organizata janë identifikuar, matur dhe sipas mundësisë, janë vendosur procedura për të shmangur ose minimizimin e tyre. Largimi i emisioneve tjera të organizatës inkurajohet.

- a. Emisionet e plota të drejta dhe jo drejta të gazit serrë monitorohen dhe drejtohen.
- b. Mbeturinat e karbonit për turist/natë monitorohen dhe drejtohen.
- c. Veprimet janë marrë për të shmangur dhe ulur emisionet vjetore nga gjitha burimet të kontrolluar nga organizata.
- d. Mekanizma për uljen e karbonit përdoren sipas mundësisë.

D2.2 Transporti

Organizata tenton të zvogëlojë nevojat për transport dhe të inkurajojë përdorimin e alternativave më të pastra dhe më efektive nga ana e konsumatorëve, të punësuarve, furnizuesve gjatë punës së tyre.

- a. Sigurohen dhe promovohen informacione për konsumatorët mbi opsionet alternative të transportit (të përshtatshme për klimën), për arritje, largim dhe gjatë vizitës së tyre.
- b. Opsionet alternative të transportit (p.sh. biçikletë me qira, ndarje të veturës, marrje nga rruga) për mysafirët dhe personelin janë të siguruar ose lehtësuar.
- c. Preferohen tregjet e aferta dhe me transport të qëndrueshëm.
- d. Favorizohen furnizuesit lokal dhe kërkohet që punët ditore të minimizojnë transportin.

D2.3 Ujërat e zeza

Ujërat e zeza, përfshirë edhe ato gringjyrë hiri, trajtohen në mënyrë efektive dhe vetëm ripërdoren ose lëshohen në mënyrë të sigurt, pa ndikime negative mbi popullatën lokale ose mjedisin.

- a. Ujërat e zeza lëshohen në sistemin e aprovuar komunal ose qeveritare, sipas nevojës.
- b. Nëse nuk ka në dispozicion trajtim komunal të ujërave të zeza, ka një sistem për trajtimin në vend të ujërave (që plotëson kriteret ndërkombëtare të ujërave të zeza) dhe siguron që nuk ka ndikime negative mbi popullatën dhe mjedisin.

D2.4 Mbetjet e ngurta

Mbetjet, përfshirë edhe ato të ushqimit, maten, ka mekanizma për të pakësuar mbetjet dhe aty ku nuk mundet, për të ripërdorur ose ricikluar. Largimi i mbeturinave nuk ka ndikim negativ mbi popullatën lokale dhe mjedisin.

- a. Organizata është e vetëdijshme për rregullimet e menaxhimit të mbeturinave në vendin kryesor të vizitës dhe synon ndikimin e tyre për përmirësim sipas nevojës dhe praktikës.
- b. Ka një plan për menaxhimin e mbetjeve të ngurta për punët e organizatës dhe atyre mbi të cilat ka ndikim/kontroll të drejtpërdrejtë.
- c. Plani për menaxhimin e mbetjeve përfshin veprime për uljen, ndarjen dhe ripërdorimin ose riciklimin e mbeturinave të ushqimit.
- d. Largimi i mbeturinave bëhet deri në objektin e aprovuar ose të shtetit dhe ka dëshmi që objekti nuk ka ndikim negativ mbi mjedisin ose popullatën lokale.
- e. Largimi i mbetjeve të ngurta matet sipas llojit dhe qëllimit për të minimizuar janë në vend.
- f. Udhëzime jepen për konsumatorët dhe personelin për minimizimin e mbeturinave.

D2.5 Substanca të dëmshme

Përdorimi i substancave të dëmshme, përfshirë edhe pesticide, bojëra, dezinfektues të pishinave dhe materiale për pastrim, minimizohet dhe zëvendësohet nëse mundet me produkte ose procese neutrale. Të gjitha ruajtjet, përdorimet dhe largimet e lëndëve kimike menaxhohen në mënyrë përkatëse.

- a. Një inventar i substancave të dëmshme është përpiluar dhe mbahen materiale për sigurinë e tyre.
- b. Janë marrë veprime për të siguruar alternativa më miqësore me mjedisin.
- c. Lëndët kimike, posaçërisht ato me shumicë, ruhen dhe menaxhohen në përputhje me standardet përkatëse.
- d. Vizitorët janë të informuar paraprakisht të shmangin përdorimin e lëndëve higjienike personale dhe substancat që mund të konsiderohen si të dëmshme për mjedisin lokal.

D2.6 Minimizimi i ndotjes

Organizata zbaton praktika për të minimizuar ndotjen nga zhurma, drita, erozioni, substanca që ndikojnë ozonin dhe ndotës të ajrit, ujit dhe tokës.

- a. Burimet potenciale të ndotjes të mbuluar me këtë kriter janë të shqyrtuar dhe identifikuar.
- b. Burimet potenciale të ndotjes të mbuluar me këtë kriter monitorohen.
- c. Janë marrë veprime për të minimizuar dhe sipas mundësisë eliminohen ndotjet nga burimet e mbuluar me këtë kriter.

SEKSIONI D: Maksimizimi i përfitimeve nga mjedisi dhe minimizimi i ndikimeve Negative

D2 Ulja e ndotjes

SEKSIONI D: Maksimizimi i përfitimeve nga mjedisi dhe minimizimi i ndikimeve negative
D3 Ruajtja e biodiversitetit, ekosistemeve dhe peisazheve

D3.1 Ruajtja e biodiversitetit

Organizata mbështet dhe kontribuon për ruajtjen e biodiversitetit, përfshirë edhe menaxhimin e duhur të pronave. Vëmendje e posaçme është dhënë zonave të mbrojtura natyrore dhe zonat me vlerë të lartë të biodiversitetit. Çdo shqetësim i ekosistemeve natyrale minimizohet, rehabilitohet dhe ka një kontribut plotësues për menaxhimin e ruajtjes.

- a. Organizata dëshmon ndërgjegjësim për zonat e mbrojtura natyrore dhe zonat me vlerë të lartë të biodiversitetit në pjesët e vizituara.
- b. Organizata siguron dhe regjistron mbështetje monetare për ruajtjen e biodiversitetit në pjesët kryesore të punës/vizitës.
- c. Organizata siguron dhe regjistron mbështetje edhe të natyrave të tjera për ruajtjen e biodiversitetit në pjesët kryesore të punës/vizitës.
- d. Pronat në pronësi ose të operuar nga organizata dhe ato mbi të cilat ka ndikim/kontroll të drejtpërdrejtë menaxhohen në mënyrë efektive për të mbështetur ruajtjen e biodiversitetit.
- e. Organizata është e vetëdijshme dhe pakson aktivitetet që mund të shqetësojnë kafshët dhe vendbanimet.
- f. Sigurohet kompensim për shqetësime që mund të ndodhin.
- g. Veprime ndërmerren për të siguruar që vizitorët mbështetin ruajtjen e biodiversitetit.
- h. Organizata angazhohet me OJQ-të lokale për ruajtje në pjesët kryesore të punës/vizitës.

D3.2 Speciet invazive

Organizata merr masa për të shmangur futjen e specieve invazive. Speciet autoktone përdoren për peizazhe dhe rinovim sipas mundësisë, në veçanti për peizazhet natyrale.

- a. Pronat në pronësi ose të operuar nga organizata dhe ata mbi të cilat ka ndikim/kontroll të drejtpërdrejtë monitorohen për pranimin e specieve invazive.
- b. Ndërmerren veprime për të siguruar që speciet invazive nuk futen ose përhapen.
- c. Ka një program për të larguar ose kontrolluar speciet invazive.
- d. Rregullimi i vendeve shqyrtohet për të marrë parasysh përdorimin e specieve autoktone.

D3.3 Vizita të vendeve natyrore

Organizata ndjek udhëzime përkatëse për drejtimin dhe promovimin e vizitave në vendet natyrore për të minimizuar ndikimet negative dhe për të maksimizuar përvojën e vizitorit.

- a. Organizata është e vetëdijshme dhe ka përpiluar udhëzime aktuale për turistët gjatë vizitave të vendeve natyrore.
- b. Udhëzimet përdoren gjatë vizitave dhe informimit të vizitorëve.
- c. Organizata angazhohet me autoritetet lokale për ruajtje për të themeluar/identifikuar çështje lidhur me vizitat në vendet përkatëse.

D3.4 Nderveprimi me kafshët e egra

Ndërveprimet me kafshët e egra, duke marrë parasysh ndikimet kumulative, janë jo-invasive dhe të drejtuar në mënyrë të përgjegjshme për të shmangur ndikimet negative mbi kafshët në fjalë dhe për gjallërinë dhe sjelljen e popullatës në rajonet përkatëse.

- a. Organizata është e vetëdijshme dhe vepron në përputhje me rregullat aktuale lokale, kombëtare edhe ndërkombëtare në lidhje me ndërveprimet me kafshët përfshirë edhe shikimin e tyre.
- b. Organizata angazhohet me zhvillimin dhe zbatimin e kodeve lokale dhe udhëzimeve për bashkëveprime me kafshët e egra, përfshirë edhe shikimin e tyre, si kërkesë, në bazë të ekspertëve.
- c. Bashkëveprimet e drejta, në veçanti ushqimi, nuk duhet të lejohet, përveç nëse nuk është lejuar me standarde ndërkombëtare, ose nëse nuk ka standarde, të udhëzuar nga ekspertë përkatës.
- d. Masat ndërmerren për të minimizuar shqetësimin e kafshëve.
- e. Ndikimet mbi mirëqenien e kafshëve monitorohet dhe adresohet në baza të rregullta.

D3.5 Mirëqenia e kafshëve

Asnjë specie e kafshëve nuk mund të merret, zbutet ose mbahet mbyllur, përveç nga personat e autorizuar dhe për aktivitete të rregulluara në përputhje me ligjet lokale dhe ndërkombëtare. Strehimi, kujdesi dhe trajtimi i gjitha kafshëve të egra dhe shtëpiake duhet të plotësojë kriteret më të larta të mirëqenies së kafshëve.

- a. Organizata është e vetëdijshme dhe e pajisur me ligjet dhe rregulloret relevante në lidhje me kafshët e kapura.
- b. Udhëzimet aktuale për aktivitete të caktuara të turizmit përfshirë kafshë të kapura zbatohen.
- c. Personat përgjegjës për kafshët e kapura kanë kualifikime përkatëse dhe përvojën dhe janë të licencuar.
- d. Organizata është e vetëdijshme dhe e pajisur me ligjet dhe rregulloret relevante në lidhje me mirëqenien e kafshëve.
- e. Ka inspektim të rregullt të kushteve të kafshëve të kapura dhe strehimi i tyre.
- f. Ka inspektime të rregullta të kushteve të kafshëve shtëpiake dhe strehimi dhe trajtimi i tyre.

D3.6 Grumbullimi dhe tregtimi i bimëve të egra

Speciet e egra nuk grumbullohen, konsumohen, shfaqen, shiten ose tregtohen, përveç si pjesë e aktivitetit të rregulluar që siguron se përdorimi i tyre është në mënyrë të qëndrueshme dhe në përputhje me ligjet lokale dhe ndërkombëtare.

- a. Organizata është e vetëdijshme dhe e pajisur me ligjet dhe rregulloret relevante në lidhje me grumbullimin dhe tregtimin e bimëve të egra.
 - b. Vizitorët janë të informuar për rregulloret që trajtojnë vjeljen, konsumimin dhe tregtimin e bimëve të egra dhe nevojën për të shmangur blerjen e produkteve/kujtimeve të paligjshme që rrjedhin nga speciet e kërcënuara, të përcaktuar nga IUCN dhe CIETES.
 - c. Aty ku lejohet, ajo paraqet një formë të qasjes për ruajtje shkencore, të drejtuar dhe të zbatuar.
-